

NJOFTIM PUNE

Profili i kompanisë: Balkan Finance Investment Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

QTU sh.p.k është pjesë e Balfin Group, Grupit më të madh dhe inovator të investimeve në Shqipëri dhe një ndër më të mëdhenjtë në rajon.

Pozicioni: Operator/e Finance-QTU
Departmenti: Financë
Vendodhja: QTU

Përshkrim i Pozicionit të Punës

Është personi përgjegjës që kryen regjistrimin dhe paraqet informacione me bazë financiare. Rakordon dhe mirëmban llogari financiare si dhe përgatit raporte financiare bazuar në kërkesat dhe politikat e grupit për këtë department.

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Ndjek kontratat me klientet, përgatit faturat e shitjes sipas termave të kontratës dhe i shpërndan brënda afateve të përcaktuara
2. Kryen kontabilizimin e faturave në sistem (NAV), ndjek dhe rakordon klientet sipas afateve të përcaktuara.
3. Përgatit e Librin e Shitjeve
4. Përgatit raportet ditore për arketimet e klienteve dhe çdo e drejtë e lindur ndaj të tremeve si dhe raporte të tjera sipas nevojave të Menaxhimit;
5. Ndjek veprimet me bankën dhe arken, regjistron në baze ditore veprimet e arkës dhe bankave dhe kryen inicimin i pagesave on-line
6. Është përgjegjëse për arkën e shoqërisë:
 - Ekzekuton pagesa dhe arketime;
 - Kryen regjistrimin e veprimeve të arkës në sistem;

- Përgatit raporte të Cash-it dhe kujdeset në administrimin e gjendjes së Cash-it të shoqërisë në bashkëpunim me Menaxherin e Financës;
 - Kryen veprimet e arkës, organizon dhe arshivon dokumentacionin e arkës në përputhje me procedurat e shoqërisë;
 - Ka përgjegjësi materiale për diferencat (nese ka) të cash-it nga inventari fizik me sistemin
7. Kryen detyra të tjera të caktuara sipas kërkesës së Menaxherit të Financës

Kërkesat e pozicionit të punës:**a. Edukimi:**

- Diplomë Universitare, Dega Financë-Kontabilitet.
- Diplomë Master Financë/Kontabilitet

b. Eksperiencat e punës:

- Jo më pak se 2-3 vite eksperiencë në të njëjtin profil.

c. Kualifikime të tjera:

- Të ketë njohuri mbi legjislacionin fiskal;
- Të ketë njohuri shume te mira te programeve te paketes Microsoft Office;
- Njohuri te programit Navision (perben avantazh);
- Të ketë njohuri te mira te gjuhes Angleze (e shkruar dhe e komunikuar);
- Trjanimet në këtë fushë përbejnë avantazh

d. Aftësi të tjera:

- Të ketë aftësi të mira të etikës dhe komunikimit;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të bashkëpunimit në grup;
- Të jetë person energjik dhe me vetëmotivim të lartë në punë;
- Të ketë aftësi shumë të mira ndërpersonale.

Mënyra e aplikimit:

Për të aplikuar për këtë pozicion, ju lutem dorëzoni dokumentet e mëposhtme:

- CV të Detajuar;
- Letër Interesi,

nëpërmjet njërës nga mënyrat si në vijim:

1. Me e-mail: hr@acrem.al
2. Duke dërguar me postë ose aplikim i drejtëpërdrejtë në adresën e mëposhtme:
“Qendra Tregtare TEG, Rruga Nationale Tiranë-Elbasan, Farkë, Lundër, Tiranë, Shqipëri”

Afati i fundit i dorëzimit: deri në dt. **17 Janar 2021**

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*